



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, në datën 19 mars 2018, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Miratimin e rregullores “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”. **(Vendimi nr. 42, datë 19.03.2018)**
2. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Radio Travel” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Travel”. **(Vendimi nr. 43, datë 19.03.2018)**
3. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Jehona” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Jehona”. **(Vendimi nr. 44, datë 19.03.2018)**
4. “Mosrinovimin e licencës së shoqërisë “Albania FM” për subjektin audio privat vendor “Albania FM”. **(Vendimi nr. 45, datë 19.03.2018).**
5. “Mosrinovimin e licencës së shoqërisë “Scorpion” sh.p.k., për subjektin audio me përsëritës “World Family”. **(Vendimi nr. 46, datë 19.03.2018).**
6. “Rinovimin e licencës së subjektit person fizik Shkëlqim Hajno, për subjektin audio privat vendor “Radio Saranda”, reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit në “*Bashkia Sarandë*” dhe ndryshimin e kushteve teknike të licencës”. **(Vendimi nr. 47, datë 19.03.2018)**
7. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Robert Hoxha, licencuar për subjektin radiofonik privat vendor “Val’ e Kaltër” duke reduktuar zonën e ofrimit të shërbimit në “*Njësia Administrative Vlorë*”. **(Vendimi nr. 48, datë 19.03.2018)**
8. “Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “REÇI KGM” sh.p.k. për subjektin audioviziv privat vendor “TV M+”. **(Vendimi nr. 49, datë 19.03.2018)**
9. “Rinovimin dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të autorizimit të shoqërisë “Mariuxho” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve

- mbështetur kabllor “Tv Kabllor Bulqiza” në “*Njësitë administrative Bulqizë, Fushë-Bulqizë, Maqellarë, Zerqan, Tomin dhe Kastriot*”. **(Vendimi nr. 50, datë 19.03.2018)**
10. “Dhënien e autorizimit, subjektit person fizik Albi Kreci, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Alb Vito Peqin” për të ofruar shërbim në “*Bashkinë Peqin*”. **(Vendimi nr. 51, datë 19.03.2018)**
 11. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Erjon Keta, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Ergi”. **(Vendimi nr. 52, datë 19.03.2018)**
 12. “Zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Cable Net” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Cable Net”, nga “*Qarku Elbasan, Bashkia Lezhë dhe Njësia Administrative Fier*” në “*Bashkia Lezhë dhe Njësia Administrative Fier*”. **(Vendimi nr. 53, datë 19.03.2018)**
 13. “Zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit Liberta Thanza, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Drini” nga “*Njësia Administrative Bushat, Velipojë dhe Gur i Zi*” në “*Njësia Administrative Bushat dhe Velipojë*” **(Vendimi nr. 54, datë 19.03.2018)**
 14. “Azhornimin e zonës së ofrimit të subjektit person fizik Gëzim Cake, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Zagorcan” në “*Njësitë administrative Udenisht dhe Bucimas*”. **(Vendimi nr. 55, datë 19.03.2018)**
 15. “Azhornimin e zonës së ofrimit të subjektit person fizik Krenar Goga, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Erden” në “*Njësitë administrative Kutalli, Cukalat, Poshnjë, Strum dhe Roskovec*”. **(Vendimi nr. 56, datë 19.03.2018)**
 16. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Sadete Jaho, për kalimin e të drejtave të autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Toshkëz” tek subjekti person fizik Mikel Jaho. **(Vendimi nr. 57, datë 19.03.2018)**
 17. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Tv Blu” sh.p.k, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Blu”. **(Vendimi nr. 58, datë 19.03.2018)**
 18. “Zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Shpresa Boriçi, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Tërbuf” nga “*Njësitë administrative Fushë Milot, Fushë Kuqe dhe Fushë Krujë, Tërbuf, Dushk, Thumanë dhe Kallmet*” në “*Njësitë administrative Tërbuf, Dushk, Thumanë dhe Kallmet*”. **(Vendimi nr. 59, datë 19.03.2018)**
 19. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Radio +2” sh.a., licencuar për subjektin audio privat vendor “Radio +2”. **(Vendimi nr. 60, datë 19.03.2018)**
 20. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Kiss FM” sh.p.k, licencuar për subjektin audio privat vendor “Kiss FM”. **(Vendimi nr. 61, datë 19.03.2018)**
 21. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Scan” sh.a., licencuar për subjektin audio privat vendor “Radio Scan” dhe subjektin audioviziv privat vendor “Scan TV”. **(Vendimi nr. 62, datë 19.03.2018)**
 22. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Sky Elbasan” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Sky Elbasan”. **(Vendimi nr. 63, datë 19.03.2018)**

23. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Tele Sport” sh.p.k. autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet satelitor “Tv Tele Sport”. **(Vendimi nr. 64, datë 19.03.2018)**
24. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 1, datë 02.02.2018, të vendosur ndaj subjektit person fizik Dorina Marini, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Andor”. **(Vendimi nr. 65, datë 19.03.2018)**
25. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 2, datë 06.02.2018, të vendosur ndaj shoqërisë “Tema TV” sh.p.k., autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet “Tema Tv”. **(Vendimi nr. 66, datë 19.03.2018)**
26. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë, nr. 3, datë 14.02.2018, të vendosur ndaj shoqërisë “Tv kabllor Shijaku” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Shijaku”. **(Vendimi nr. 67, datë 19.03.2018)**

Tiranë, 19 mars 2018

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SUBJEKTET PER NDRYSHIME NE PRONESI

Per mbledhjen tjetër

- 3DS&AF entertainment
- Club tv # ne pronësi
- Gener 2
- TOP ALBANIA RADIO (shkrese)

shijak per dosje